

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME

## Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

## AKTET NËNLIGJORE PËR SISTEMIN E ADRESAVE DHE MANUALI I DIXHITALIZIMIT, KRIJIMI I HARTES VEKTORIALE

## PASQYRA E LËNDËS

#### FAQE

1.	Urdhër nr. 1411 datë 10.12.2008 për Miratimin e modelit të adresës dhe radhën e vendosjes së elementëve të saj III
2.	Udhëzim nr. 1412 datë 12.12.2008 për Rregullat e numërtimit të ndërtesave në fshatra kur nuk ka mundësi të emërtimit të rrugëve VI
3.	Urdhër nr. 1445 datë 22.12.2008 për Miratimin e Rregullores për rregullat e punës në hartë për numërtimin e ndërtesave dhe përcaktimin e adresës së shtetasve nga bashkitë/komunat/njësitë bashkiakeIX
3.1	Rregullore për rregullat e punës në hartë për numërtimin e ndërtesave dhe përcaktimin e adresës së shtetasve nga bashkitë/komunat/njësitë bashkiakeX
4.	Formulari i vendbanimitXIV
5.	Manual dixhitalizimi. Ndërtimi i hartës vektoriale. Sistemi kombëtar i adresave1

Π



#### REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME M I N I S T R I

## URDHËR

#### Nr. 1411, datë10 /12/ 2008

PËR

## MIRATIMIN E MODELIT TË ADRESËS DHE RADHËN E VENDOSJES SË ELEMENTËVE TË SAJ

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 2 të ligjit Nr. 9951 datë 10.07.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave", me qëllim zbatimin e një procesi unik të pasqyrimit të adresës, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

## URDHËROJ:

 Elementet e adresës do te shkruhen sipas kësaj radhe; emri i rrugës,/bulevardit/sheshit/parkut numri i ndërtesës "Nd", numri i hyrjes "H", numri i apartamentit "Ap", emri i fshatit, emri bashkisë /komunës, kodi postar, emri i rrethit. Dhe ne rastin e Bashkisë Tirane, emri i rrugës,/bulevardit/sheshit/parkut numri i ndërtesës "Nd", numri i hyrjes "H", numri i apartamentit "Ap", emri i njësisë bashkiake, kodi postar. TIRANE Në çdo rast emri i rrugës si dhe emrat e bashkisë, komunës, njësisë bashkiake dhe rrethet shkruhen me germa te mëdha. Nëse ka shkurtime pas tyre vendoset

- ""
- 2. Elementet për ndërtesën, hyrjen dhe apartamentin do të shkruhen në një rresht dhe do të ndahen ndërmjet tyre me shenjen ", " ose ";". Në rastet kur mungon ndonjë nga elementet ne shkrimin e adresës do të thotë se ndërtesa ka përkatësisht një hyrje dhe hyrja ka vetëm një apartament. Në këtë rast do te shkruhet vetëm numri i ndërtesës.
- **3.** Emrat që përcaktojnë elementet fshat/qytet/ njësi bashkiake për Tiranën, komunë/bashki dhe kodi postar , do të shkruhen në nje rresht të ndarë midis tyre me shenjen " , " dhe ";".

- **4.** Emri i Rrethit do te shkruhet në rreshtin e fundit në rastet kur kemi adresë brenda vendit dhe kur kemi adresë për jashtë vendit do të shtohet dhe emri i shtetit.
- 5. Modeli i shkrimit do të jetë sipas rasteve të mëposhtme;

#### a. Në rastet kur kemi për të shkruar adresën në bashkinë e Tiranës;

Rr. "MYSLYM SHYRI"	Rr. "MYSLYM SHYRI"
Nd. 5, H.2, Ap. 12	Nd; 5, H.2; Ap. 12
Njësia Bashkiake Nr.10,Kodi Postar	Njësia Bashkiake Nr.10; Kodi Postar
TĪRANË	TIRANË

b. Në rastet kur kemi për te shkruar adresën ne një bashki qendër rrethi me emër te njëjtë me rrethin;

Rr. "JANI VRUHO" Nd.5, H.2, Ap.12 Kodi Postar BERAT Rr. "JANI VRUHO" Nd.5; H.2; Ap.12 Kodi Postar BERAT

#### c. Në rastin e një bashkie me emër te ndryshëm nga Rrethi;

Rr. "DELIALLISI" Nd. 42, H. 1, Ap. 3 SUKTH, Kodi Postar DURRËS

Rr. "DELIALLISI" Nd. 42; H.1; Ap.3 SUKTH; Kodi Postar DURRËS

Rr. "SKËNDERBEU" Nd. 42, H. 1, Ap. 3 LAÇ, Kodi Postar KURBIN Rr. "SKËNDERBEU" Nd. 42; H.1; Ap.3 LAÇ ; Kodi Postar KURBIN

#### d. Në rastet e një fshati me emër ndryshe nga emri i bashkisë/komunës,

Rr. "AVNI BAJRAMI"Rr. "AVNI BAJRAMI"Nd. 24, H.1, Ap.3Nd. 24; H.1; Ap.3Sheqeras,VRESHTAS, Kodi PostarSheqeras;VRESHTAS; Kodi PostarKORÇËKORÇË

#### e. Në rastet e një fshati te njëjtë me emrin e komunës,

Rr. "E LISIT"	Rr. "E LISIT"
Nd. 12, H.1, Ap.5	Nd. 12, H.1, Ap.5
VRESHTAS, Kodi Postar	VRESHTAS; Kodi Postar
KORÇË	KORÇË

- **6.** Te gjitha institucionet publike, personat juridike e fizike zbatojnë modelin e adresës në çdo format zyrtar që kërkohet. Kryetaret e Bashkive /Komunave u dërgojnë të gjithë institucioneve publike, te gjithë personave juridike dhe fizikë adresën përkatëse, si dhe lajmërimin sa here që ajo ndryshohet.
- 7. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
- 8. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne fletore zyrtare.





#### REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME M I N I S T R I

## UDHËZIM

#### Nr. 1412, datë 12 /12 / 2008

PËR

## RREGULLAT E NUMËRTIMIT TË NDËRTESAVE NË FSHATRA KUR NUK KA MUNDËSI TË EMËRTIMIT TË RRUGËVE.

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit Nr. 9951 datë 10.07.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave", me qëllim zbatimin e një procesi unik të numërtimit të ndërtesave në fshatra, kur nuk ka mundësi emërtimi të rrugëve, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

## **UDHËZOJ**:

1. Në zonat rurale do të zbatohet si rregull parimi i numërtimit te ndërtesave, sipas ligjit nr. 9270 datë 29.07.2004 "Për Sistemin e Adresave" i ndryshuar.

2. Në ato fshatra që nuk kemi mundësi të emërtimit të rrugëve do të zbatojmë parimin e pikave 1 dhe 2, të nenit 21 të ligjit Nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për Sistemin e Adresave", i ndryshuar.

3. Zyrat e urbanistikës/personi i ngarkuar, fillimisht do të përcaktojë territoret;fshatra apo lagje brenda një fshati, ku nuk ka mundësi të bëhet emërtimi i rrugëve.

4. Fshatrat e përcaktuara ne piken 3 do te klasifikohen si:

- Fshatra qe janë të përbërë nga lagje
- Fshatra me shtëpi të grupuara si një grup i vetëm i përbashkët

5. Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar, pasi të ketë bërë këtë lloj përcaktimi do të fillojë të bëjë numërtimin e ndërtesave.

6. Kur ndërtesat janë te përbëra nga lagje, numërtimi i ndërtesave do të bëhet sipas lagjeve, të cilat më parë duhet të marrin një emër. Emri i lagjes do të zëvendësojë emrin e rrugës edhe në adresë. Numri i çdo ndërtese që ndodhet në këtë fshat do të lidhet me emrin e lagjes së këtij fshati. Numërtimi i ndërtesave do të fillojë me numrin 1 (një) për ndërtesën e parë që ndodhet në hyrje të lagjes dhe do të vazhdojë progresiv.

Numërtimi do të ndjekë kahun e lëvizjes së akrepave të orës, me rregull nga jashtë brenda, duke krijuar kështu një spirale që mbyllet në qendër të grupit. Numrat e ndërtesave të çdo lagje nuk duhet të përsëriten. Shih fig.1.



Fig.1 Adresa për fshatrat e ndarë në lagje do të shkruhet në këtë forme.

Lagja GROPAS Nd. 1, H. 2, Ap.4. Mucaj, Rremas,Kodi postar Lushnjë.

7. Kur në fshat nuk mund të emërtojmë rrugët dhe ndërtesat klasifikohen si një grup i vetëm i përbashkët, atëherë numërtimi i ndërtesave do të fillojë me numrin 1 ( një) për ndërtesën e parë që ndodhet në hyrje të fshatit dhe do të vazhdojë progresiv. Numërtimi do të ndjekë të njëjtat kritere si në pikën 6. Shih Fig 2.



#### Fig. 2 Adresa për këtë kategori fshatrash do te shkruhet ne këtë forme.

#### Nd.2, H.1, Ap.4 Drithas, Sheqeras, Kodi postar Korçë

8. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen të gjithë Kryetarët e Komunave që kanë në përbërje të tyre fshatra të cilët janë subjekt i nenit 21 të ligjit Nr. 9270, datë 29.07.2004 " Për sistemin e adresave", i ndryshuar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

10. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.





### REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME M I N I S T R I

## URDHËR

#### Nr. 1445, datë 22/12/ 2008

#### PËR

## **MIRATIMIN E RREGULLORES**

#### PËR

#### RREGULLAT E PUNËS NË HARTË PËR NUMËRTIMIN E NDËRTESAVE DHE PËRCAKTIMIN E ADRESËS SE SHTETASVE NGA BASHKITË/KOMUNAT/ NJESITE BASHKIAKE

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës b) të nenit 61 të ligjit Nr. 8950, datë 10. 10. 2002 "Për gjendjen civile", me qëllim zbatimin e një procesi unik adresimi, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

## URDHËROJ:

- 1. Miratimin e rregullores "Për Rregullat e punës në hartë për numërtimin e ndërtesave dhe përcaktimin e adresës se shtetasve nga Bashkitë/Komunat/ Njësitë Bashkiake".
- 2. Për zbatimin e kësaj rregullore ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Bashkitë/Komunat/ Njësitë Bashkiake të Tiranës.
- 3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME M I N I S T R I

## RREGULLORE PËR RREGULLAT E PUNËS NË HARTË PËR NUMËRTIMIN E NDËRTESAVE DHE PËRCAKTIMIN E ADRESËS SË SHTETASVE NGA BASHKITË/KOMUNAT/NJËSITË BASHKIAKE

1. Përpara fillimit të procesit të numërtimit të ndërtesave, zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar, krijon një shtrese (layer) në të cilin, duhet të pasqyrojë fillimin e çdo PTP-je me shenjën e "shigjetë me ngjyrë **jeshile**" dhe të mbarimit, me "shigjetë me ngjyrë **të kuqe**". Kjo përcakton drejtimin/pikënisjen nga ku do të fillojë numërtimi i ndërtesave, adresa e të cilave do të lidhet me PTP-në përkatëse.

**2.** Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar do të analizojë informacionin që paraqitet në hartë me gjendjen aktuale në terren, për ndryshime të mundshme (p.sh ndërtesa, rrugë, rrugica, sheshe, parqe të reja, ose prishje apo transformime të tyre).

**3**. Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar pasi ka dixhitalizuar të gjitha pjesët e territorit publik dhe pasi ka hedhur gjithë emërtimet përkatëse për çdo PTP (rrugë/rrugicë/bulevard/shesh/park/autostradë), në përputhje me Rregulloren "Për Rregullat e Punës në Hartë për Adresimin e Pjesëve të Territorit publik nga Bashkitë/Komunat", pasqyron ne shtresa (layer) të veçantë:

- të gjithë gjeometrinë e ndërtesave (gjurmët e objekteve) brenda territorit të Bashkive/Komunave. Kjo shtresë (layer) titullohet "Ndërtesat",
- numrin përkatës të ndërtesave. Shtresa (layer) titullohet "Numërtimi i Ndërtesave".

**4.** Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar duhet të përcaktojë saktë informacionin për ndërtesat, që kanë fasadë dhe hyrje/dalje në dy rrugë. Ky informacion duhet të përmbajë;

- numrin e hyrjeve/daljeve të tyre,

- pozicionin e tyre.

Në rastet kur ky informacion nuk është i plotë apo i pasaktë duhet verifikuar në terren.

**5.** Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar mbasi ka verifikuar dhe ka azhornuar të gjitha ndryshimet në hartën e punës fillon procesin e numërtimit ku si fillim krijon gjashte shtresa (layer) të reja:

- a. Në shtresën (layer)-in e parë përcaktohet fasada e ndërtesës, nëpërmjet shenjës rreth, të komandes Pike (point), me ngjyrë të kuqe, i cili do të bëjë lidhjen e poligonit të ndërtesës me PTP-në nga e cila do të marrë adresën. Kjo shenjë do të vendoset jashtë poligonit të ndërtesës, nga ana e së cilës kanë pamjen të gjitha hyrjet/daljet për në ndërtesë, duke përcaktuar kështu adresimin e ndërtesës, duke pasur parasysh edhe rastet kur ndërtesa ka funksion të përzier.
- **b.** Në shtresën (layer)-in e dytë përcaktohet drejtimi e hyrjeve/daljeve me shenjen rreth, të komandës Pikë (point), me ngjyrë blu. Pikat vendosen jashtë poligonit të ndërtesës, përballë vendndodhjes së çdo hyrje/dalje, të cilat do të përcaktohen si të tilla, sipas kritereve të ligjit Nr. 9270, "Për sistemin e adresave".
- c. Në shtresën (layer)-in e tretë do të vendosen numrat, me ngjyrë blu për hyrjet/ daljet e ndërtesave, sipas kritereve të përmendura në nenin 14, pika 2, e ligjit Nr. 9270, "Për Sistemin e Adresave". Numrat e hyrjeve/daljeve do të vendosen brenda poligonit te ndërtesës.
- d. Në përfundim të këtyre do të krijohet shtresa (layer) i katërt, në të cilin do të shënohen numrat e çdo ndërtese, me ngjyrë të kuqe. Numri i ndërtesës do të vendoset brenda poligonit të ndërtesës. Numërtimi do të kryhet sipas kritereve të përcaktuara në nenet 8 24, të ligjit nr. 9270 "Për sistemin e adresave" (shih manualin "Për sistemin e adresave".
  Për fshatrat do t'i referoheni Udhëzimit të Nr. 1412, date 12.12.2008, te Ministrit të Brendshëm, "Për rregullat e numërtimit te ndërtesave ne fshatra kur nuk ka mundësi të emërtimit te rrugëve".
- **dh.** Gjatë procesit të adresimit në zyrë/terren, do të përcaktohet edhe vendi i vendosjes së tabelave me emrat e rrugëve, duke respektuar parimet e ligjit për këtë proces. Vendi i cili tregon vendosjen e tabelave me emrat e rrugëve në hartën dixhitale do të jetë në një shtrese (layer)-in të veçantë me titullin "Tabela", ne te cilën do te punohet me një Pike(point) me ngjyre portokalli.
- e. Kur të mbarojë adresimi do të krijohet një shtresë (layer) e veçantë për përcaktimin e zonave te adresimit sipas kodit 10 shifror zgjedhor. Kjo shtresë do të jetë e formës Polyline dhe do te ketë kriterin kufi të qendrës së votimit.
- **ë.** Pas kësaj do te krijohet një shtresë (layer) të veçantë për përcaktimin e zonave të adresimit sipas kriterit të kodit postar. Kjo shtrese do të jetë e formës Polyline dhe do te ketë kriterin kufi të teritorit që përfshihet në të njëjtin kod postar.

**6**. Pas krijimit të këtyre "layer" përcaktohet numri i apartamenteve në çdo ndërtesë dhe emri i shtetasve që banojnë në çdo apartament, duke krijuar kështu adresën e çdo shtetasi.

7. Për adresimin e saktë të çdo ndërtese/apartamenti e lidhur me emrin e shtetasve që banojnë në adresën përkatëse përdoret formulari tip, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje i cili do të ketë të listuar të gjithë elementët e adresës sipas ligjit, si dhe elementë të tjerë të përcaktuar nga DPGJC-ja si të domosdoshëm.

**8.** Grupi i punës i ngritur sipas Urdhrit Nr. 1080, datë 28.08.2008, për adresimin në terren dhe popullimin e çdo apartamenti, ngre grupe të adresimit, numri i të cilëve varet nga territori dhe numri i familjeve të njësisë, dhe nga koha ne dispozicion për të kryer këtë veprimtari. Për çdo grup caktohet një territor mundësisht i barabartë nga pikëpamja e numrit të familjeve.

**9**. Grupet e adresimit përbëhen nga dy persona, njëri prej të cilëve të jetë Administratori/ Kryetari i fshatit i cili e njeh shumë mirë territorin dhe tjetri një punonjës i administratës. (ose një person i jashtëm psh shërbimi postar, në varësi të pagesës që mund të bëhet nga Bashkitë/Komunat).

**10**. Para fillimit të punës Grupet e Adresimit pajisen me një dosje që përmban:

-formularët tip për adresimin e çdo apartamenti përkatës

-hartë për territorin që do të mbulojnë dhe do të dalin në teren duke filluar nga fillimi i çdo rruge që ata kanë për të plotësuar.

**11.** Grupi i Adresimit fillimisht do të plotësojë formularin tip për çdo ndërtesë. Pasi kemi hedhur të gjithë informacionin ku përfshihen : rrethi, bashkia/komuna, emri i rrugës, nr. ndërtesës, nr. hyrjeve/daljeve për çdo ndërtesë, do të fillojë numërtimi i apartamenteve dhe vendosja e emrit të personave për çdo apartament. Ky grup do të shkojë në çdo ndërtesë duke identifikuar çdo apartament dhe qëllimin funksional të tij.

**12.** Në këtë formular do të plotësohet dhe një rubrikë e përbëre nga 16 kutia. Këto kutia përfaqësojnë :

- tre kutia janë për shifrat e numrit të "kodi i zyrës së gjendjes civile"
- katër kutia janë për shifrat e numrit të rrugës përkatëse, që fillon nga 1 dhe rritet në progresion.
- katër kutia janë për shifrat e numrit të çdo ndërtese, për çdo rrugë ku ajo merr adresë.
- dy kutia janë për shifrat e numrit të hyrjes/daljeve të çdo ndërtese
- tre shifra janë për numrat e apartamenteve që ka çdo hyrje.

Ky do të jetë dhe kodi personal i adresës për çdo shtetas.

Ky kod do të shërbejë për lidhjen e bazës së të dhënave të regjistrit të adresave me regjistrin kombëtar te gjendjes civile, që do të thotë me çdo shtetas.

**13**. Grupi i punës i përbërë nga dy persona pasi ka plotësuar formularin me të gjitha rubrikat e tij në dy kopje, pasi të ketë bërë identifikimin e çdo apartamenti, do të vendosë këtë numër në formular. Pasi të ketë vendosur numrin e apartamentit do të kontaktojë me familjarët, duke u dhënë atyre të plotësojnë emrat për të gjithë personat e familjes që banojnë në apartamentin përkatës.

**14**. Çdo formular do të plotësohet në dy kopje, nga të cilat një i jepet familjes dhe tjetri do të dorëzohet në zyrën e urbanistikës/personit të ngarkuar.

15. Zyra e urbanistikës /personi i ngarkuar pasi ka marrë këto formularë hedh këtë informacion në programin Auto Cad ( në formën dhe mënyrën e përcaktuar në manual) dhe njëkohësisht në programe të posaçme Databazë. Kjo Databaze do të jetë pjesë e Sistemit të Adresave. Pasi të krijohet kjo databazë të gjithë këto formular ia kalon zyrës së gjendjes civile përkatëse.

**16**. Zyra e gjendjes civile pasi të marrë këta formularë me përgjegjësi do të plotësojë kodin 16 shifror në rubrikën e regjistrit kombëtar për çdo shtetas.

17. Formularet dhe i gjithe materiali tjetër ruhen në njësinë përkatëse vendore.

**18.** Ky proces do të përfundojë brenda datës 30.01.2009 dhe brenda datës 05.02.2009 një kopje e materialit duhet të dorëzohet në DPGJC.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

# FORMULAR VENDBANIMI (ADRESA)

Shënime:

Adresa	l. Rruga	2. Nr. Ndërtesës	3. Nr. Hyrjes	<ol> <li>Apartamentit</li> </ol>	5. Bashkia/Komuna	5. Rrethi	7. Kodi Postar	

_	Kodi Z.Gj.C	Nr. Rrugës	Nr. Ndës	Nr. Hyrjes	Nr. Ap.

	Emri	Atësia	Mbiemri		Datëline	dja
Nr.				Dita	Muaji	Viti
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						
7.						
8.						
9.						
10.						

DO OI

Pronësi

Statusi i Banesës

Apartament në Pronësi Apartament me Qira Apartament tjetër në

Kryefamiljari

Specialisti

\* Përcaktimi i shtetasit/shtetasve sipas adresës në bazë familje



## REPUBLIKA E SHQIPERISË MINISTRIA E BRENDSHME Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile



# MANUAL DIXHITALIZIMI

NDËRTIMI I HARTËS VEKTORIALE SISTEMI KOMBËTAR I ADRESAVE

## Përmbajtja e Manualit

HYRJE	3
I. INFORMACION	4
1.1 Materiali Ortofoto	4
1.2 Programet e Përpunimit	5
II. NDËRTIMI I LAYER-AVE TË PUNËS	6
III. FUTJA E ORTOFOTO-s NË AUTOCAD	9
IV. DIXHITALIZIMI MBI ORTOFOTO	12
Dixhitalizimi i akseve të rrugëve	14
Simbolet për fillimin dhe mbarimin e çdo PTP	16
DIXHITALIZIMI I NDERTESAVE	19
Përcaktimi i Hyrjes /Daljes kryesore në ndërtesë	
dhe i të gjitha hyrjeve në ndërtesë	19
Identifikimi i vendndodhjes te tabelave	21
Kufijte e qendrave te votimit dhe zonave postare	22
V. PROCESI I TOPOLOGJISË	23
5.1 Procesi i pastrimit të të dhënave	23
5.2 Vendosja e simboleve për opsionin "Interactive "	24
5.3 Krijimi i topologjise:	25
VI. HEDHJA E ATRIBUTEVE (KARAKTERISTIKAVE)	
PER CDO ELEMENT GJEOGRAFIK NE DATABAZE - AutoCAD	
6.1 Krijimi i databazes se rrugeve	
6.2 Krijimi i databazes se ndertesave	
6.3 Dhënia e atributeve për çdo element	

faqe

# HYRJE

Një shtet demokratik dhe me standarde t-ë larta të ndërtimit dhe funksionimit të tij, nuk do të kishte kuptim pa një infrastrukturë të plotë dhe funksionale të sistemit të adresave. Kjo është baza e një komunikimi të saktë dhe tepër të nevojshëm për një vend që aspiron zhvillim dhe konsolidim të shtetit ligjor të orientuar nga ekonomia e tregut.

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash në të gjithë infrastrukturën e saj që lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me ekzistencën e një sistemi funksional dhe modern të adresave dhe referencave gjeografike të sakta të tyre. Reforma në drejtësi për një përmirësim dhe ngritje më cilësore të marrëdhënieve të pronësisë mbi pronën, Sistemi Modern Financiar(bankar), përmirësimi dhe ngritja në standarde të Identitetit të shtetasve dhe shumë aktivitete të tjera jetike për vendin tonë, kërkon një shërbim të standardeve ndërkombëtare të sistemit të adresave.

Për këtë qëllim Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile si autoritet i Qeverisë Shqiptare për hartimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit Kombëtar të Adresave, ka ndërmarrë një iniciativë të rëndësishme në drejtim të reformimit dhe modernizimit të sistemit të adresave në Republikën e Shqipërisë.

Problemet teknike që ndërthuren në këtë reformë janë të shumta dhe komplekse, pasi koncepti i sistemit të adresave në vendin tonë shoqërohet dhe me vetë emancipimin e shoqërisë në këndvështrimin e referencës gjeografike që ajo mbart dhe nevojën e pazëvendësueshme të informacionit hartografik të përditësuar.

Në kushtet e një informacioni ekzistues tepër të amortizuar, të pa përditësuar dhe në shumë raste të pasaktë, e bëjnë të domosdoshme gjenerimin e hartës vektoriale nga Ortofoto që përbën një nga materialet bazë ku ne do të referohemi. Ky është një koncept i ri i gjenerimit të informacionit dhe domosdoshmëria e një manuali për shfrytëzimin e kësaj Ortofoto-je përbën një rëndësi të madhe në mbështetjen dhe realizimin me sukses të këtij sistemi.

# I. INFORMACION

## I.I Materiali Ortofoto

**Ortofoto**, në kushtet e mungesës së theksuar të informacionit hartografik, përbën materialin bazë për gjenerimin e hartës vektor. Kjo ka rëndësi të madhe pasi informacioni hartografik i kthyer në trajtë vektor do të përpunohet dhe kthehet në trajtë topologjike të saktë dhe do të bëjë të mundur lidhjen me Database-n përkatëse të sistemit të adresave.

**Ortofoto** si informacion hartografik i prodhuar me metoda fotogrametrike përfaqëson në këndvështrimin teknik, transformimin e fotografive ajrore të marra nga aeroplani, sipas një metodike të përcaktuar shkencore. Fotografitë ajrore pasi pësojnë një proces transformimi nga plani i pjerrët në atë horizontal dhe futjen e korrekturave të transformimit nga projeksion qendror në atë ortogonal si dhe transformimin për reliev. Këto fotografi të transformuara mund të paraqesin qartë zonën e mbuluar me fotografim. Mbi këtë fotografim (tashmë Ortofoto) të jepet mundësia që në mënyra elektronike të kryesh matje ose saktësime të ndryshme pa vajtur në terren.

Duke përdorur Ortofoto, ne mund të kryejmë një digjitalizim korrekt, të shpejtë dhe me kosto të ulët. Gjithashtu, saktësia e informacionit që ne gjenerojmë prej saj, plotëson të gjitha parametrat teknike topografike për shkallen e hartës që kërkohet (1:2000).

Fokusimi paraprak i punës bëhet në materialin bazë, i cili është Ortofoto-ja, ajo mund të paraqitet në disa formate, ndër të cilat mund të përmendim:

- 1. Formati .TIF + .TIFW
- 2. Formati **.JPG** + **.JPGW**

Pjesa e parë e formatit të Ortofotos (.JPG/.TIF) konsiston në imazhin e prodhuar nga fotografimi ajror. Në rastet punës mbi ortofoto nevojiten koordinata gjeografike të cilat janë të specifikuara në baze të një Sistemi Gjeoreferencimi. Pikërisht këto koordinata janë të vendosura në file-t që shoqërojnë File-Imazhet, këto janë respektivisht formatet (.TIFW/.JPGW)

Përmbajtja e këtyre formateve konsiston në koordinatat X,Y,Z të cilat janë përpunuar në bazë të Projeksionit UTM, i cili është aktualisht më i përdoruri në rang botëror. Si pjesë përbërëse e materialit Ortofoto ky file është automatikisht i verifikuar nga programi në të cilin do të kemi futjen e Imazheve (formati i shpërndarë nga DPGjC është .JPG+.JPGW).

## I.2 Programet e Përpunimit

Mundësia e dixhitalizimit të materialit Fotogrametrik (Ortofoto) dhe krijimi i hartës Vektoriale mund të kryhet në disa variante dhe me disa lloje programesh specifike. Disa nga këto programe mund të jenë:

Autodesk Map 3D, Arc GIS, ERDAS Image, MapInfo, Stereo Analyst, etj.

Për të mundësuar një proces sa më efektiv dhe të kënaqshëm, DPGjC udhëzon në kuadrin e administrimit të sistemit të adresave përdorimin e programeve të mëposhtme të cilat karakterizohen si programe digjitalizimi dhe programe të zhvillimit dhe database-s:

- Autodesk Map 3D (2004) Program Digjitalizimi
- ArcView (familja Arc GIS) Programe të Zhvillimit dhe Database-s

## Hyrje e shkurtër informative mbi sistemet e punimit me hartat

*Autodesk Map 3D*: ofron një shërbim profesional në realizimin e dixhitalizimit mbi materialin Fotogrametrik. Autodesk është një tërësi programesh të projektuara për qëllime inxhinierike të parapërcaktuara, të cilat në kompleksitetin e tyre arrijnë qëllime të larta.

*ESRI-ArcView*: Projektuar për të krijuar një modalitet veprimesh në fushën e shërbimeve GIS (Geographic Information System). Ky program do të mundësojë lidhjen e informacionit vektorial (i marrë nga Autodesk Map 3D) me bazën e të dhënave që do të krijohet gjatë mbledhjes së të dhënave në terren si dhe nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (informacion ky i marrë në format EXCEL, sipas udhëzimeve që do të shpërndahen në fazën e duhur për mbledhjen e informacionit)

Përgjatë fazave të përcaktuara për sistemin e adresave kemi një ndarje fazë-program. Faza e parë e cila përfshin atë të dixhitalizimit do të kryhet duke përdorur programin Autodesk Map 3D. Faza e dytë e cila është relativisht e mëvonshme, do të realizohet nën përdorimin e programit ArcView ose Arc GIS.

# II. NDËRTIMI I LAYER-AVE TË PUNËS

Krijimi i shtresave në mënyrë standarde është i domosdoshëm për ngritjen e sistemit të adresave pranë çdo NJ.Q.V. Për secilën kategori ndërtesa ose rruge etj, duhet të ndërtohet një Layer i veçante, i cili duhet të jetë unik në llojin e tij.



Kjo kuti dialoguese mundëson specifikimet për çdo Layer. Në të do të përcaktohet, ngjyra, lloji i vijave, trashësia e vijës, etj.

> Layer-at do të ndërtohen në varësi të nevojave të punës që do të kërkohet:

<sup>&</sup>lt;sup>1</sup> Për të gjitha përshkrimet e shtigjeve do të përdoret karakteri (/) shembull File/Print.

EMRI I SHTRESAVE	NGJYRA	KODI I NGJYRES
ORTOFOTO (imazhet)	Për çdo Ortofoto krij	ioni Layerin (shtresen) e saj
AKSET E RRUGËVE	blu	05
EMËRTIMI I RRUGËVE	bardhë	07
Fillimi dhe Mbarimi i Rrugëve	jeshile/kuqe	03/01
NDERTESA	portokalli	30
NUMËRTIMI I NDËRTESAVE	portokalli	30
HYRJA/DALJA KRYESORE	kuqe	02
Gjithë Hyrje/Daljet Ne Ndërtese	blu	05
NUMRI I HYRJEVE	blu	05
SHESHET	magenta	06
PARQET	jeshile	03
TABELAT	e kaltër	130
Kufi (Bashki/Komune)	verdhë	02
Kufijtë e Qendrave te Votimit	lejla	210
KUFIJTË POSTAR	verdhë	50

Në vazhdimësi të dixhitalizimit do të ndërtohen dhe layera të tjerë që do t'i shërbejnë procesit.

Hapi 3: Klikojmë në komandën "New Layer",

për të mundësuar krijimin e

Layer-it të ri. Në vazhdimësi të rreshtit të Layer-it bëjmë specifikimet përkatëse (ngjyrën, llojin evijës, etj). Pasi të kemi krijuar të gjithë Layerat e përmendur me sipër, klikojmë **OK**. Shiko fig.3



Fig.3

Në përfundim të këtij procesi do të kemi si rezultat Layerat e kërkuar të cilët do të paraqiten si në figurën e mësipërme.

Mbasi kemi klikuar Ok shfaqet në ekran fleta e punës që mund të ruhet me emrin "sistemi i adresave\_emri i bashkisë /komunës .dwg Kontrollojmë layer-at që krijuam në Toolbar-in" Shiko fig.4



Fig. 4

# III. FUTJA E ORTOFOTO-s NË AUTOCAD

Për rastet kur nuk kemi hartë vektoriale por kemi vetëm ortofoto, duhet të veprojmë si poshtë:

• Në menunë vertikale me zbritje shkojmë tek menuja "Map" selektojmë: *Image/Insert (sipas figurës)* 



## **KUJDEŚ:** Ortofoton duhet ta insertoni (fusni) me komandën Map-Image-Insert dhe jo me komanden Insert-Raster Image

Pasi të kemi vepruar si më siper do të shfaqet në ekran një kuti dialoguese, e cila do të na mundesojë futjen e imazhit (Ortofoto) në Autodesk Map.

Në kutinë dialoguese **"Insert Image"** zgjedhim një Ortofoto duke përcaktuar më përpara direktortinë në të cilën ndodhet imazhi (imazh JPG i cili është në disqet e shpërndara nga DPGjC). Ortofotot e shpërndara janë të gjeoreferencuara në bazë të sistemit UTM, çka mundëson lehtësimin e procesit të dixhitalizimit.

KUJDES:	and a standard from the firm and the second the second sec					
Në kutinë		et et la contra			W 55 G = .	
dialoguese				四日 王 中 志		
"Insert Image",	190	Inseni Imoge	14. A.			<b>10</b>
NUK DUHET LËNË E KLIKUAR kutiza "Modify	1-19011000	Look in hiji Darumente Documente Davision Hiji Documente Hiji Documente	PIESAE PARE     TERNAR, A, DR. 20     T	IIIIIIIII.00     IIIIIIIIII.00     IIIIIIIIII	TELANA, J. IN. 17 TELANA, J. J. N. 17 TELANA, J. J. S. 19 TELANA, J. J. S. 19 TELANA, J. J. S. 19 TELANA, S. 19 TE	THERMOLULAN TRANSPORT
Correlation" dhe "Show Frame Only"————		Ng Lierquier He Network	Phonese I Pice of type:	TIPNAN A 00 All ten ("1 Cardolen		Diam Cancol I Inte

Pasi të selektoni File-Imazhin, klikoni Open.-



Në këtë mënyrë Ortofotoja e cila do të shfaqet në faqen e punës do të jetë gati për dixhitalizim (shiko fig. mëposhtme).



10

Shënim: Duke mbajtur në fletën e punës një numër prej 4 ose më shumë Ortofoto-sh do të krijohen probleme me përballimin e tyre nga ana e PC (kompjuterit). Për këtë arsye, ju rekomandojmë që gjatë procesit të punimit mbi Ortofoto, dixhitalizimi të kryhet në varësi, me 1-2 Ortofoto të hapura në fletën e punës.

Pasi të jetë shfaqur Ortofoto në ekran e selektojmë atë dhe e vendosim te Layer-i ORTOFOTO\_IMAZHET që kemi krijuar i cili ndodhet në toolbars-in "*filter applied*". Shiko fig.4

## IV. DIXHITALIZIMI MBI ORTOFOTO

Dixhitalizimi i PTP-ve, ndërtesave dhe kategorive të tjera etj,sipas strukturës së layerve mundëson grumbullimin e të gjithë informacionit të domosdoshëm për ecurinë e sistemit të adresave dhe krijimin e hartës vektoriale sipas standardeve të përcaktuar nga DPGjC.

Dixhitalizimi konsiston në vizatimin në ekran (kompjuter) me vija, akset e rrugëve, gjurmët e ndërtesave apo me pikë hyrjet në ndërtesë apo vendodhjet e tabelave etj.

Në varësi të ortofotos mund të kemi spostime të objekteve, fakt ky i krijuar nga ana e Fotografimit Ajror. Kështu që marxhini i lehtë i gabimit i cili është për efekt të detajeve mbi objekte të pasqyruara nga ALUIZNI-i, nuk do të merret në konsideratë nga ne.

Për këtë arsye duhet vëzhguar mirë pamja e objektit dhe të realizohet poligoni i tij i mbyllur. Procesi i lartë përmendur mund të kryhet me anë të komandës "OSNAP". Kjo komanda kryen pozicionimin e pikës së fundit tek pika e fillimit duke realizuar kështu një mbyllje të plotë të poligoneve.

Komandat "OSNAP" ndodhet respektivisht në menunë poshtë rreshtit të komandave.

Duke klikuar me	IN THE MI Model (Leyout) (Leyout2)
butonin e djathtë të	
mausit tek reshti i	Commend:
menusë " <mark>OSNAP</mark> ",	Command:
do të shfaqet një	34,0000, 3,5000, 0,0000 SNAP GRID ORTHO POLAR OSNAP OTRADK DUCS DYN LWT MODEL

kuti dialoguse dhe klikojmë mbi Settings. Shiko figurën me poshtë.

Mbasi të kemi selektuar **"Setting...**" do të shfaqet Tabela Dialoguese e rregullimeve të menusë "OSNAP.

	PolarSnap On
Command:	Off
_ Command:	Settings
23.5000, 1.0000 , 0.0000	SNAP GRID UNTHU POLA

#### Duhet patur parasysh:

• Të gjitha vijat të cilat do të përfaqësojnë rrugët të ndërtohen me



- Të gjitha vijat duhet të jenë të bashkuara me njëra tjetrën.
- Bashkimet e rrugëve duhet të bëhen në një pikë të vetme.



Tabela dialoguese "Drafting Settings", shërben për të rregulluar opsionet që nevojiten dhe lehtësojnë dixhitalizimin. Duke specifikuar ndërprerjen e vijave ose fillimin dhe mbarimin e një vije, procesi i mbylljes së poligoneve realizohet më shpejt dhe me më shume saktësi.

Nga të gjitha specifikimet duhen mbajtur të aktivizuara vetëm

#### (Endpoint, Intersection, Nearest.)

Pasi të keni dhënë specifikimet e duhura klikoni **OK**.

Në tastierën e kompjuterit , tasti F3 aktivizon/çaktivizon "SNAP" që e bën më të lehtë procesin e dixhitalizimit.

Snap and Gald Poles Tracking Ot	oper Sinap	Dynamic Input:	
Divid Snop On (F3)		Direct Snap Track	ing On (Fill)
- Blied Snap motes	-		
E Endpoint	B	insteen	Solect All
A IN Idooini	b.	Peperdo,la	Gest/4
O E Center	o	Tergent	
55 Node	X	Newsit	
O Quadrant		Apparentinteracci	ion .
× Direstation	11	Paulal	
- Edmin			
Taihack from an Oan command: A hacking Taihag teoloing peu	ap point, p g vector ago se over the	num over the point whi peaks often you sover t spoint again	laina hecusar

Mbasi kemi aktivizuar Osnap-et, fillojmë me dixhitalizimin e të gjithë elementeve që do të na shërbejnë për sistemin e adresave.

Në Toolbar-in" *filter applied* "bëjmë aktiv layer-in KUFI dhe mbasi zgjedhim komandën POLYLINE



SHENIME: Në këtë rast kemi katër ortofoto. Duhet të krijojmë aq layer-a imazhe sa ortofoto kemi. Në këtë rast krijojmë katër layer-a imazhe.

Mbasi kemi bërë Map /Insert/ Image në faqen e punës dhe futet ortofotoja, fillojmë të dixhitalizojmë kufirin e NJ.Q.V-se në layerin "KUFIRI".



## Dixhitalizimi i akseve të rrugëve

Mbasi kemi përcaktuar kufirin e NJ.Q.V-se fillojmë të dixhitalizojmë akset e rrugëve, brenda territorit te NJ.Q.V-se në layerin "**AKSET e RRUGEVE**". Bëjmë aktive këtë layer tek komanda (*filter applied shiko fig 4.)* dhe fillojmë të dixhitalizojmë aksin (mesin) e çdo rruge .

Zgjedhim komandën POLYLINE, afrojmë Ortofoton sa të shikojmë aksin e rrugës dhe fillojmë të dixhitalizojmë aksin (mesin) e rrugës. Në rastet kur rruga është e drejtë pikat merren larg e larg kurse kur rruga ka kthesa pika merret sa më afër, që kthesa të dalë sa më e qartë.

Specialisti mbasi mbaron me dixhitalizimin e rrugëve në bashkëpunim me këshillin bashkiak ose këshillin e komunës fillon hedhjen e emërtimeve të rrugëve/bulevardeve/ shesheve/parqeve dhe përcakton fillimin dhe mbarimin e çdo rruge në layerin **"Fillimi dhe Mbarimi i rrugëve"**.

Specialisti për çdo rrugë që ka një emër krijon një layer me emrin e rrugës dhe e vendos atë segment rruge në atë Layer. Të njëjtën gjë bën më të gjithë rrugët e emërtuara dhe krijon aq layera sa rrugë ka.



Shembull: Në qoftë se në Bashki/ Komunë kemi 30 rrugë që marrin emërtime do të krijohen 30 shtresa.

COS CONTROL OF CONTROL	Research step 10 [1] the second second being	the second second second second second	
	DEE BUR -DDJ F	NOVE HEINER & States - of States	
	14 15 15 15 15 15 15 15 15 15 15	C C C C H C C C C C C C C C C C C C C C	
			"hat had been the

Rrugët/rrugicat të cilat janë degëzime të rrugëve kryesore dhe nuk përmbushin kushtin për të marrë emërtim për shkak se kanë më pak se 10 ndërtesa, do të vendosen në atë Layer Rruge nga të cilat ato degëzohen.

### Shembull:

Rruga kryesore do të këtë në përbërje të saj edhe 10 apo 20 degëzimet të tjera të cilat nuk janë emërtuar për shkak të ligjit ose të mos vendimmarrjes së bashkisë/komunës.

Gjate procesit të punës mund të ndodhë që PC*(kompjuteri)* juaj të ngarkohet shumë, dhe si rezultat do t'u sjellë ngadalësim ose bllokim të tij. Për këtë arsye ju rekomandojmë të keni parasysh:

- Mos mbani hapur programe të tjera gjatë punimit në AutoCAD
- Mos mbani të gjithë Layer-at e Ortofotove njëkohësisht të aktivizuar

Procesi i çaktivizimit të Layer-it mund të kryhet në këtë formë. Nëpërmjet menusë së shkurtuar "*Toolbar-in e Layer-it*", e cila ndodhet në pjesën e poshtme të menuve vertikale.

Duke klikuar në Toolbarin me (*filter applied shiko fig 4.)*, do ju shfaqen të gjithë Layer-at që keni ndërtuar.

Pasi të keni hapur (*filter applied shiko fig 4.*), do të veproni në këtë mënyrë për të çaktivizuar Layer-at:



Në anën e majtë të emrit të Layer-it ndodhen disa korniza të cilat kanë specifikat te ndryshme.

Për të çaktivizuar Layer-at duhet të klikoni tek korniza në formë llambushke, e cila me t'u çaktivizuar do të kalojë në formatin e mëposhtëm.

V 🔍 🔍 🕲 🗆 0	×
0 0 0 0 0 0	
🖓 🥥 🐏 🍘 🗖 Layer I	
🖓 🦲 🐏 狗 🗖 Laper2	
🖓 🧿 🐏 🤭 🗖 Laper3	
🖓 🙆 🐏 🕲 🗖 Laper4	
🖓 🥶 🐏 🗋 Laports	
🖓 🥥 🖳 🕲 🗖 Layer6	
🖓 🥘 🐏 🍅 🗖 Layer7	
🖓 🧿 🐏 🎦 Layerð	
🖓 🥥 🔍 🔟 Layer 9	



Mbasi mbarojmë me dixhitalizimin e akseve të rrugëve dhe emërtimin e çdo rruge që ka më shumë se dhjetë ndërtesa, aktivizojmë layerin me emrin "**Fillimi dhe mbarimi i rrugëve**". Klikojmë (*filter applied shiko fig 4.)* dhe bëjmë aktive këtë layer.

## Simbolet për fillimin dhe mbarimin e çdo PTP

Ky layer **"Fillimi dhe mbarimi i rrugëve**" do të përmbajë 2 simbole me shenjën e shigjetës, të fillimit dhe të mbarimit të çdo rruge/rrugice/bulevardi/autostrade/ sheshi/parku.

Simbolet me shigjetë përcaktojnë drejtimin/pikënisjen nga ku do të fillojë numërtimi i ndërtesave, adresa e të cilave do të lidhet me këtë rrugë/rrugicë/bulevard/autostradë /shesh/park.

Shigjetë konvencionale :





Hapi 1 : Simbolet do të vizatohen në AutoCAD në një faqe të re vizatimi.Hapi 2 : Simboli do të selektohet i gjithi si në figurën më poshtë.



Hapi 3 : Klikojmë në menunë vertikale Draw dhe zgjedhim Block / Make.

**Hapi 4** : Hapet kutia dialoguese 'Block Definition'. Në të përcaktohet emri i bllokut që po krijoni për simbolin e fillimit apo të mbarimit.

and the second s		10.16
Minute Page		
 Pain part Phile part X 0.0000 Z 0.0000 Entry: Block ant Inden Decemption	Chante Chatain Chatain Chavan's block Chavan's block Chav	
Hyperbit	Carcel H	4p

Hapi 5 : Nëse duhet të modifikoni simbolin që keni krijuar aktivizoni '**Open in block** editor' treguar me shigjetë të kuqe në figurën me sipër dhe do të hapet një dritare e re ku mund të editoni gjeometrinë dhe atributin për simbolin. Mbasi keni modifikuar dhe ruajtur simbolin mbylleni dritaren tek '**Close Block Editor**'

	 N.
Brettici Ad	Class Sick Edge
	$\geq$



**Hapi 6 :** Në shtresën **'Fillimi dhe mbarimi**' nëpërmjet menusë *Insert / Block* zgjidhni simbolin e pikënisjes ose të mbarimit .





Gjatë procesit të përcaktimit të pikënisjeve dhe mbarimeve në shtresat '*PTP*', '*SHESHE*', *dhe 'PARQE*' këto shtresa duhet të jenë vizive, , por aktive dhe ku do të hidhen simbolet/blloqet duhet të jenë shtresa 'Fillimi dhe mbarimi'.

## Dixhitalizimi i ndërtesave

Informacioni që duhet të dixhitalizohet për ndërtesat është gjurma e çdo objekti (ndërtesat) në layerin '*Ndërtesat*', hyrja kryesore në layerin '*Hyrja/DaljaKryesore*' dhe të gjitha hyrjet për në ndërtesë (banesë+biznese) në layerin '*Të gjithë hyrjet në ndërtesë*'. Hyrja kryesore do të shërbejë për të përcaktuar adresën e objektit, ndërsa përcaktimi i të gjitha hyrjeve në ndërtesë do të ndihmojë fillimisht të përcaktoni hyrjen kryesore dhe më vonë në fazën e vendosjes së tabelave për çdo hyrje.

Pasi bëjmë aktive layer-in **"Ndërtesat"**, me komandën polyline fillojmë digjitalizimin e të gjitha gjurmëve të ndërtesave që do të numërtohen. **Kujdes**: përdorni gjithmonë "SNAP " për të mbyllur poligonin (gjurmën e objektit).

## Përcaktimi i Hyrjes /Daljes kryesore në ndërtesë dhe i të gjitha hyrjeve në ndërtesë.

Fillimisht krijohen Layer-at përkatës (shih fig.3):

- 1. Layer "Hyrja/Dalja kryesore ", ngjyrë e Kuqe, trashësia 0.40mm
- 2. Layer "Gjithë Hyrjet/daljet në Ndërtesë", ngjyrë Blu, trashësia 0.40mm

Pasi janë krijuar Layer-at me emërtimet përkatëse, fillohet identifikimi i të gjithë hyrjeve në ndërtesë dhe hyrjes/daljes kryesore (proces ky i mbështetur në Ligjin Nr. 9270 datë 29.07.2007 " Për Sistemin e Adresave"

Identifikimi i hyrjeve do të kryhet nëpërmjet komandës Point (që përfaqëson një pikë) kjo pikë do të jetë i formës katrore me një rreth të mbivendosur. *(mbështetur në Rregulloren për numërtimin e ndërtesave në Bashki/Komuna)* 

Për të bërë një pamje të saktë të pikave të cilat do të përfaqësojnë hyrje/daljet e objekteve, bëhet rregullimi i formës dhe madhësisë së tyre vizuale. Kjo pjesë realizohet nëpërmjet komandës **Format**/ **Point Style** 

Klikojmë tek Point Style dhe do të na paraqitet tabela dialoguse "**Point Style**", në të cilën do të identifikojmë formën e pikës dhe madhësinë e saj.

Tek kjo tabelë do të Zgjidhni si formë pike **Rrethin te shkruar brenda Katrorit** *(si në figurë),* madhësinë e pikës **1.0000 Units** dhe do të selektoni **Set Size in Absolute Units.** Klikoni **OK** për të ruajtur ndryshimet.

Pasi të jenë bërë ndryshimet e formës së Pikës bëhet identifikimi i çdo hyrje/dalje të objekteve si dhe hyrja kryesore në të, kjo duke vendosur pikë në vendin ku ndodhet hyrja(pikat do të vendosen brenda poligonit të

objektit). Pikat e hyrje/daljeve do t'i korrespondojnë Layerit përkatës.

Pasi të jetë bërë identifikimi i të gjitha hyrje/daljeve të ndërtesave do të fillojë procesi i numërtimit të tyre duke u bazuar në parimin majtas -numra tek dhe djathtas-numra çift.

Numri i hyrjeve të ndërtesave do të jetë i njëpasnjëshëm (për aq sa hyrja ka ndërtesa)

Për këtë proces do të krijohen dy layer për numrat e ndërtesave:

- Layer "Numërtimet e Ndërtesave", ngjyrë portokalli (30), trashësia 0.30mm
- Layer "Numërtimi i Hyrjeve", ngjyrë Blu (5), trashësia 0.30mm



Sidedalk biop 30 - [Brootag 1. dog]



Pasi të jetë aktivizuar Layer-in për numrat e ndërtesave do të fillohet vendosja e numrave në fletën e punës. Ky proces do të realizohet me anë të komandës **Multiline Text** (*A*).

Aktivizojmë komandën Multiline Text dhe shkruajmë fillimisht numrat për çdo objekt duke i vendosur ato respektivisht brenda poligonit të objektit *(çdo objekt do të marrë një numër të veçantë)*. Numërtimi bazohet te Ligji 9270 dhe drejtimi i shigjetës së fillimit do të përcaktojë drejtimin e numërtimit. Pjesa tjetër e numërtimit konsiston në vendosjen e numrave të hyrjeve të ndërtesave.



## Identifikimi i vendndodhjes të tabelave

Procesi i identifikimit të vendndodhjes të tabelave konsiston në vendosjen e pozicionit të saktë të vendndodhjes së tabelave në rrugët e Bashkisë/Komunës.

Ky informacion do të hidhet në Layerin "Tabela".

\*Ky Layer do të këtë ngjyrë e kaltër "130" dhe trashësi 0.30mm

Me komandën Point do të bëjmë identifikimin e vendndodhjes së tabelave. Pasi të jetë bërë ky proces do të kemi një pamje të hartës si në figurën më poshtë;



## Kufijtë e qendrave të votimit dhe zonave postare

Në shërbim të sistemit të adresave do të dixhitalizohen edhe kufijtë (zonat)zgjedhorë dhe kufijtë postare që përfaqësojnë ndarjen e zonave sipas kodit postar, Ky informacion do të dixhitalizohet me polyline në layerat përkatës dhe do të jenë poligone të mbyllura. Kujdes: përdorni SNAP gjatë dixhitalizimt dhe mbylljes së poligoneve.

## 1. "Kufijtë Postar" – do të përcaktohet kufiri i zonave në bazë të Kodit Postar.

#### Layer **"Kufijtë Postar"** - Ngjyrë e Verdhë (50)

Numrat për çdo kufi postar do të shkruhen në qendër të çdo poligoni.

#### Layer "Kufijtë e Qendrave te Votimit" - Ngjyrë Lejla (210)

Kufijtë do të përcaktohen në bazë të qendrave te votimit dhe numrat për çdo kufi do të shkruhen në qendër të çdo poligoni. Numrat që përfaqësojnë çdo kufi të qëndrës së votimit të hidhen në shtresën "Numrat e qëndrave të votimit"

## Kujdes: Përdorni "SNAP" gjatë dixhitalizimt dhe mbylljes së poligoneve

# V. PROCESI I TOPOLOGJISË

Topologjia është proces i përcaktuar për krijimin e një formati hartografik të standartizuar i cili do të japë ecurinë e mëtejshme të punës në përshtatje me kërkesat e sistemit. Kjo fazë krijohet në programin Autocad MAP.

## 5.1 Procesi i pastrimit të të dhënave

Kur filloni procesin e pastrimit të punës dhe krijoni një topologji kini parasysh:

- Krijoni një kopje rezervë (back-up) të punës suaj (file-it) në AutoCAD. Procesi i pastrimit "Drawing Cleanup" dhe i krijimit të topologjisë "Topology" mund të ndryshojë disa elemente në të dhënat tuaja dhe ju gjithmonë duhet të kini një kopje rezervë përpara fillimit të këtyre dy proceseve.
- Pastrimi ndikon tek elementet në shtresat "layers" që janë OFF (çaktivizuar) të cilat nuk janë vizive në hartën tuaj në ekran. Por nuk ndikon tek elementet në shtresat që janë të ngrira (FROZEN)
- Përpara se të krijoni topologjinë, ngrini (freeze) të gjitha shtresat që kanë elemente brenda tyre. Përndryshe , këta elementë do të përfshihen në topologji kur zgjidhni opsionin "Select All" dhe mund të pësojnë ndryshime.
- Vendos një emër unik për topologjinë që të ketë lidhje edhe me karakteristikat e vetë shtresës. P.sh "Topologjia për rrjetin e rrugëve "
- Vendos një përshkrim për topologjinë. Kjo iu ndihmon ju apo dhe përdoruesit e tjerë të përcaktojnë cilën topologji të përdorin më lehtësisht.
- Pastroni me mjetin "Drawing Cleanup" çdo shtresë "layer" më vete.
- Kujdes: përdorimin e pastrimit automatik për të gjitha elementet në të gjitha shtresat që keni krijuar.
- Përpara se të krijoni topologjinë (psh. të akseve të rrugëve ose të ndërtesave), bëni pastrimin e të gjithë elementeve gjeografike që keni në çdo shtresë më vete me të gjitha opsionet që ndodhen në mjetin e Drawing Cleanup
- Çdo opsion që do të zgjidhni për pastrimin e të gjithë punës suaj pas dixhitalizimit, gjen gabime të tipeve të ndryshme, si p.sh, dublikime të vijave, vijat e rrugëve nuk janë të bashkuara në kryqëzime ose elemente që janë dixhitalizuar gabimisht në gjatësi-zero (zero-length objects ) etj dhe duhen korrigjuar me kujdes secili prej tyre.
- Simbolet që përdoren gjatë procesit të pastrimit janë të njëjta me simbolet që përdoren gjatë krijimit të topologjisë
- Kujdes : Kur korrigjoni gabimet do të bëhen përjashtime kur rrugicat pa krye ndërpriten vetëm në një krah dhe do të lihen te tilla

## 5.2 Vendosja e simboleve për opsionin "Interactive "

Kur zgjidhni opsionin <u>"Interactive"</u> gjatë procesit të pastrimit programi i AutoCAD vendos simbole me ngjyra dhe forma të ndryshme në vendet me gabime dhe ju ndihmon t'i lokalizoni shpejt ato dhe të vlerësoni nëse këto gabime duhet të korrigjohen.

Nëse ju korrigjoni një gabim , simboli i mëparshëm hiqet. Nëse ju nuk e korrigjoni gabimin (përjashtime kur rrugicat pa krye ndërpriten vetëm ne një krah), ju mund te hiqni simbolin edhe kaloni tek gabimet e tjera.

Ju mund të zgjidhni një simbol edhe një ngjyrë për çdo opsion që do të zgjidhni gjatë pastrimit të elementëve.



Which blocks and colors do you want to use for error markers?

Parameters Erase markers when cleanup s Maintain markers when comma	tarta nd ends	Marker size: 5"	*	
Blocks and colors				
Delets Duplicates:	Dictagon	~	Cyan 📃	Y
Erase Short Objects	Octagon	v	Red	~
Break Crossing Objects:	Dctagon	V	Yellow	~
Extend Undershoots:	Octagon	~	Green	~
Span Dustered Nodes	Square	V	Blue	~

Nëse ju korrigjoni gabimet <u>automatikisht</u>, gabimet nuk shënohen me simbole si në rastin kur zgjidhni "Interactive"

Figurat më poshtë tregojnë disa shembuj të gabimeve që procesi i pastrimit "Drawing Cleanup" korrigjon dhe përshkruan opsionet e ndryshme që ndodhin gjatë pastrimit.

Përpara pastrimit	Mbas pastrimit	Gabimi/problemi	Zgjidhja
	$\leq$	Elemente Dublikat	Pastron Dublikatat
	<b>~</b>	Elemente të shkurtër	Pastron elementet e shkurtër
	$\ge$	Elemente që ndërpriten	Bën ndërprerjen e tyre
$\geq$		Elemente që duhet të lidhen	Zgjat (bashkon vijat)
$\geq$	$\geq$	Pastron vijat e tepërta pas ndërprerjes	
· · ·	•	Pastron Elementet Zero	-gjatësi

## 5.3 Krijimi i topologjisë:

## Konvertimi i Polylines në Poligone

Gjate procesit të dixhitalizimit të ndërtesave ju përdoret mjetin "Polyline" .Në mënyrë që të kemi poligone për çdo gjurmë objekti (ndërtesë) duhet të konvertoni të gjitha polylines e mbyllura në poligone .Gjatë këtij konvertimi polyline origjinal fshihet dhe zëvendësohet me polygon.



## Konvertimi i "Polygon Topology" në Poligone

n. Brendshme\Desktop\prove.dwg] Modify Express Window Map Givi Acrobat Markups Adobe PDF Help Convert Topology to Polygons

Ju mund të krijoni poligone nga topologjia e poligoneve .

**Topologji për rrjetin** - përfshin të gjitha elementet që paraqiten me vijë. Shembuj : rrjeti i rrugëve, i hidrografisë etj.

**Topologjia për poligonet** - krijon topologjinë e poligoneve që paraqesin sipërfaqe të mbyllura si psh: gjurmët e objekteve, kufijtë administrativë, kufijtë e qendrave te votimit, kufijtë postarë, parcelat, etj. Një segment i vetëm përcakton vijën e përbashkët midis 2 (dy) poligoneve fqinje. Pastrimi i vijave të mbyllura ("layer" i ndërtesave) duhet bërë përpara krijimit të topologjisë.

Select Ubjects	Which objects do you want to clean and anchor?
Eleanup Actions Disanup Methods Enor Marken	Objects to include in drawing cleanup   Select all   Layers:   Object classes:   Automatic Selection   Objects to enchor in drawing cleanup   Select manually:   Select manually:   Objects to enchor in drawing cleanup   Select manually:   Objects to enchor in drawing cleanup   Objects to enchor in drawing cleanup   Select manually:   Objects to enchor in drawing cleanup   Select manually:   Objects to enchor of drawing cleanup   Select manually:

Select Objects	Which cleanup act	ions do you want to use?	
Cleanup Actions Cleanup Methods Error Markett	Cleanup Actions  Defete Duplicates  Erase Short Objects Break Crossing Objects Extend Undershoots Apparent Intersection Snap Clustered Nodes Dissolve Pseudo Nodes Erase Danging Objects Simplify Objects Zero Length Objects Weed Polylines	Selected Actions Add> Fizmove	Cleanup Parameters
Load Save	Options Interactive	Cancel C Back Next	> Frush Helo

Select Objects	Which cleanup actio	ns do you want to use?	
Cleanup Actions Cleanup Methods Ende Marker	Delete Duplicates Ease Shot Objects Break Crossing Objects Extend Undershoots Apparent Intersection	Selected Actions Delete Duplicates Erase Short Delects Break Crossing Objects Extend Undershoots Snap Clustered Nodes	Cleanup Perameters
	Snep Clustered Nodes Dissolve Pseudo Nodes Erase Danging Objects Simplify Objects Zero Langhi Objects Weed Polylines	Add > Zero Lenoth Objects	
	Options		

## VI. HEDHJA E ATRIBUTEVE (KARAKTERISTIKAVE) PER CDO ELEMENT GJEOGRAFIK NE DATABAZE - AutoCAD

Karakteristikat e çdo elementi në hartën tuaj do të ruhen në një tabelë që do të krijoni nëpërmjet komandës **"Object Data"** Kjo tabelë ruan informacion në format teksti ose numerike për çdo element në hartë. Karakteristikat e çdo elementi (p.sh. emri i rrugës, lloji i saj , kodi i rrugës, numri i ndërtesës, emri i ndërtesës nëse ka, kodi i ndërtesës, lloji i ndërtesës (banesë, institucion, shkollë, qendër biznesi etj), emri njësisë administrative/bashkiake/lagjes , emri i NJ.Q.V-se, etj) bashkëngjiten nga tabela tek elementet tuaj gjeografik që keni dixhitalizuar.

Do të krijoni **4 (katër) tabela** për shtresat që kane karakteristika sipas tematikës përkatëse në hartën tuaj. Një tabelë për layerin e **ndërtesave**, një tabelë për layerin **akset e rrugëve**, një tabelë për **sheshet**, një tabelë për **parqet**, dhe mund të krijoni edhe tabela të tjera nëse do të nevojiten gjatë procesit të implementimit të sistemit të adresave apo për punën tuaj në urbanistikë.

## 6.1 Krijimi i databazës së rrugëve

## *Si të krijoni një tabelë me të dhënat për elementin tuaj gjeografik*:

Hapi 1: Klikoni në menunë MAP /Object Data dhe zgjidhni: Define Object Data



Hapi 2: Pasi te klikojmë ne menune '*Define Object* Data' , do te hapet kutia dialoguese '**Define Object Data**' dhe klikoni ne '**New Table**' për të krijuar një

tabele te re. Shkruajmë emrin e tabelës **'RRUGET'** tek **'Table Name'**. Kjo tabelë do të përmbajë disa fusha siç janë tabelat ne EXCEL.

	Table: New Table
	Object Data Fields
	Field Definition
	Data Type:
	Description:
	Default
	Modfy Rename Delete
	Close Help
	No object data tables are present.
ne New O	bject Data Table
e Name:	RRUGET
oject Data F	ields

**Hapi 3:** Pasi keni krijuar tabelën , do të përcaktoni disa fusha me emrin përkatës, përshkrimin e tyre, tipin e të dhënave. Tabela për rrugët do të përmbajë disa fusha siç janë tabelat në EXCEL. Fushat do të jene: EMRI, KODI, TIPI, NJ.Q.V., SHENIME . Për të krijuar një fushe të re, shkruaj emrin e fushës **EMRI** në **'Field Name'**:

- Shkruaj përshkrimin në 'Description' për çdo fushë.
- Zgjidh tipin e fushës <u>Character</u> në 'Type' për të gjitha fushat që do të krijoni . Tipi specifikon llojin e informacionit që do të shkruhet në fushë. P.sh. Nëse ju specifikoni tipin numerik, nuk mund të shkruani tekst në këtë fushë.

Object Data Fi	elds	
		Delete
		Distate All
Field Name: Description: Default:	EMRI Type: Emri i rrugeve	Character V Integer Character Point Real
	Add Lodate	

**Hapi 4:** Zgjidhni '**Add**' për të shtuar një fushe të re në tabelë p.sh Kodi, Tipi, Shënime . Shtoni fusha të tjera në tabelë dhe shtypni '**OK**'.

Specifikoni emrin në 'Default' Define New Object Data Table për një fushe që ka gjithmonë të Table Name: RRUGET njëjtën vlerë. Kjo karakteristikë **Object Data Fields** i bashkëngjitet njëherazi çdo EMRI elementi. KODI TIPI P.sh. Në tabelën "Rrugët" apo SHENIME Delete All "Ndërtesat" për fushën me emrin 'NJ.Q.V' ose Rrethi do të **Field Definition** shkruani emrin e bashkisë/ Field Name: Type: Character komunës suaj dhe të gjithë Description elementët në shtresat tuaja do të Default: marrin këtë emër si në figurën më poshtë; 0K Cancel Help **Field Definition** Field Name: NJQV Type: Character Description: Default: Bashkia Elbasan Add

v

Help

Cancel

## 6.2 Krijimi i databazës së ndërtesave

**Hapi 1:** Pasi keni perfunduar dixhitalizimin e ndertesave , ndërtoni tabelën për layer -in "**Ndërtesa**". Do të kryeni të njëjtat hapa siç janë përmendur më sipër për krijimin e tabelës "**Rrugët**".

0K

1. Klikoni në menunë MAP /Object Data dhe zgjidhni: Define Object Data

2. Pasi të klikoni në menunë '*Define Object* Data', do të hapet kutia dialoguese 'Define Object Data' dhe klikoni në 'New Table' për të krijuar një tabelë të re. Shkruajmë emrin e tabelës 'NDERTESAT' tek *'Table Name'*. Kjo tabele do të përmbajë të gjitha fushat të përmendura më poshtë. Tabela për "**NDERTESAT**" do të përmbajë disa fusha të renditura si më poshtë qe do te shkruhen tek 'Field name':

- 1. Numri i ndërtesës
- 2. Kodi i ndërtesës
- 3. Kodi 10 shifror zgjedhor
- 4. Emri i Rrugës
- 5. Numri i Hyrjeve
- 6. Numri i Apartamenteve
- 7. Numri i Zyrave (nëse është biznes)
- 8. Numri i njësive tregtare
- 9. Numri i kateve
- 10. Lloji i ndërtesës
- 11. Njësia Administrative/ bashkiake
- 12. Nj.Q.V.
- 13. Rrethi
- 14. Kodi postar
- 15. Shënime

Përshkrimet e tyre do të shkruhen tek : **'Description'** 

able Name:	NDERTESAT	
Object Data Fi	elds	
NUMBI	Delete	
	Delete A	
Field Definition		
Field Name:	NUMRI Type: Character	4
Description	Numiiinderteses	]
Default		Ī
	Add	
	inda indata	
[	OK Cancel Help	
1		

able Name:	NDERTESAT			
Object Data Fi	elds			
NUMRI			-	
			Delo	16;
			Delete	A
Field Definition				
Field Name.	1.01	Time	100000	123
Description		- itype:	Integer	-
D. T. J.	Tipi i nderteses-banese/bi	iznes/etj		
Deraulo				-
	A44	(Instate)		
	Add	uposie		
F	OK Cancel	EH	elp	

Object Data Fi NUMRI	sids		
LLDJI			Delete
e		4	Delete All
Field Definition			
Field Name:	KODI Elektoral	Type:	Integer
Description:	kodi 10 shitror qe perdore	t per zgjedh	e
Default:			
	-	(Ladata	

# 6.3 Dhënia e atributeve për çdo element gjeografik në hartë.

Do të veprohet në këtë mënyrë:

Hapi 1: Klikoni në menunë MAP/ Object Data dhe zgjidhni 'Attach/Detach Object Data'.



Hapi 2 : Pasi klikoni në 'Attach/Detach Object Data' do të hapet kutia dialoguese 'Attach/Detach Object Data' si më poshtë:

**Hapi 3:** Selektoni fushën 'Emri i rrugëve' dhe tek **'Value'** shkruani karakteristikat e elementit tuaj p.sh. emrin e rrugës, të sheshit ose numrit te ndërtesës etj.

able:	RRUGET	*		1.5
Dbject D	ata Field:	Value to J	Altach:	
Emilian KODI	igeve			
TIPI	ИE			
<				>
Name:	EMRI			
/alue:	RRUGA VASO PAS	HA		
Action				
Accon				
	Attach to Ubjects <	Deta	ch from Ubjects <	
	verwrite			_
-	Defec	OK Cana		

**Hapi 4:** Pasi keni shkruar atributin për çdo element, do të shtypni butonin '**Attach to Objects**' dhe në hartë do të shfaqet simboli i selektimit . Selektoni elementin - rrugë (ose ndërtesë në rastin kur do të shkruani numrin e saj) . Edhe nëse rruga ka disa segmente do të selektohen të gjitha dhe do ti jepet i njëjti atribut elementit .

Nëse gjatë procesit të dhënies së atributeve bëhen gabime, selektohet elementi dhe zgjidhet **'Detach from objects'** pra atributi do të shkëputet prej elementit tuaj.

Në rastet kur do ti jepet një atribut i ri elementit gjeografik, opsioni 'Overwrite' në kutinë dialoguese 'Attach/Detach Object Data' duhet të jetë i aktivizuar dhe emri apo numri i ri do të zëvendësoje të vjetrin. Përndryshe do të ruajë emrin e vjetër dhe të ri.



1.Zgjidhni menune 'Edit Object data' per ti dhene atributet cdo ndertese.

- 7 -	Drawings	• 📓 📓 📓 😻 😻 🖉
	Query	•
	Save Back	•
	Feature Classification	•
	Object Data	Define Object Data
	Database	Attach/Detach Object Data
	Data Entry	Edit Object Data
	Image	Define Document View      View Associated Document
	Topology	•
	Map Book	
	Annotation	· III II5
	Tools	•
	Inquiry	•
	Utilities	•
	Options	

2. Zgjedh objektin qe do ti jepen atributet si në figurën me poshtë:



3. Për objektin që sapo keni zgjedhur do të jepni atributet për çdo fushë si në tabelën me poshtë. Kalimi nga nje fushe ne tjetren behet me enter. Tek "**Numri**" do të shkruani numrin e ndërtesës dhe do të shtypni "Enter".

	Edit Object Data	
	Table:         NDERTESAT         Image: Nested Data           Object Data Field:         Value:	LWPOLYLINE
Γ	Numi inderteses Tipi i inderteses-banese/biznes/etj 10.shiftor 0	Next
/ F m   10	2kt/5kt/6kt/8kt 0	Prior
/ Land L	emni i bashkise /komunes Elbasan	Firm
<u> </u>		Last
		> Record #: 1
	Name: NUMRI Value:	
	Select Object < Incert Record Delete	Record

4. Pasi keni perfunduar me hedhjen e numrit ne fushen e pare do të zgjidhni fushën e dytë "LLOJI" i ndërtesës dhe do të shkruani tipin e ndërtesës , banese ose biznes etj. Shtypni Enter dhe në të njëjtën mënyre do të veproni për çdo fushe tjetër. Pasi të keni mbaruar me hedhjen e të dhënave për çdo fushe shtypni "OK".

	Edit Object Data	
	Table: NDERTESAT Value:	LWPOLYLINE
	Numri i nderteses 111 Tipi i nderteses-banese/biznes/etj 10 shiltor 0 or lotal i anatamenteve 0	Ned
/ <u></u>	2ki/5 ki/6ki/6kik 0 emriibashkise Akomunes Elbasan	Fint
	<	Record #:
	Name: LLDJI Value: BANESE	
	Select Object < Insert Record Del DK Cancel Help	ete Record

er i abi ce manen ce anenac per çae rabite, cabeta ao ce nece panifer	5.	Pasi të	hidhen	të dhënat	për çda	fushe,	tabela do të	ketë këtë pamje .
---	----	---------	--------	-----------	---------	--------	--------------	-------------------

	Table	NDERTESAT	~	Nested Data	LW	POLYLINE
	Object D-	ala Field	Value:			
	Numi i n Tipi i nde 10 shifro	iderteses arteses-banese/bizn (	111 es/etj 1112222333	BANESE		Next
	nr total i	apartamenteve	15			Prior
·····	emri i ba	shkise /komunes	Elbasan			Fast
m						Láit
	<				>	Record #: 1 of 1
	Name:	NUMBI_Katev	e			
	Value	5				
	and the second	[				
		Select Libr	ect ( Inse	t Hecord Uelei	e Hecc	brd

Tabelat që do të krijoni do të mbartin të gjitha atributet (karakteristikat) e elementeve gjeografikë në harte. Këto tabela do të përdoren në fazën kur i gjithë informacioni gjeografik dhe tabelor do të eksportohet në programin ArcView /GIS.





Ky material është përgatitur në kuadër të projektit për modernizimin e sistemit të adresave dhe të gjendjes civile, financuar nga BE dhe zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

